REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 327, Datë 03.11.2026**

**MBI**

**REGJISTRIMIN E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "ALBPOWER" SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 6 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 230, datë 18.08.2026; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2751/3 prot., datë 03.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "ALBPOWER" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike",*

**Konstatoi se:**

- Shoqëria "ALBPOWER" sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 664, Seria T26, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 261 , datë 11.09.2026, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2751 prot., datë 11.09.2026, shoqëria ka depozituar kërkesën për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike "Zëmblak BESS".
- Rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe nenin 3 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026.
- Shoqëria kishte deklaruar se impianti do të lidhej me rrjetin e OST sh.a., në Nënstacionin Zëmblak 400/110/20 kV, por nuk kishte depozituar dokumentacionin përkatës, sipas pikës VI të Formularit të Regjistrimit, Aneksi 1, të Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar. Për këtë arsye, ERE, me shkresën nr. 2751/1 prot., datë 14.10.2026, i kërkoi shoqërisë depozitimin e dokumentacionit përkatës, në rast se e dispononte.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2751/2 prot., datë 20.10.2026, shoqëria ka bërë me dije se është në pritje të regjistrimit të impiantit të depozitimit të energjisë nga ERE, me qëllim vijimin më pas të procedurës së aplikimit pranë shoqërisë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a. për lidhjen e impiantit "Zëmblak BESS" në Nënstacionin Zëmblak 400/110/20 kV.
- Rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe të Rregullave për regjistrimin në ERE të

impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026. Shoqëria "ALBPOWER" sh.p.k. ka paraqitur formularin e plotësuar, dokumentacionin teknik dhe atë financiar për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike "Zëmblak BESS", me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 60 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 240 MWh.

- Për sa më sipër, vlerësohet se plotësohen kushtet për vijimin e procedurës së regjistrimit të këtij impianti në kuadër të licencës nr. 664, Seria T26, të dhënë shoqërisë "ALBPOWER" sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 261, datë 11.09.2026, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Sipas informacionit të paraqitur nga shoqëria, procedura për lidhjen e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike "Zëmblak BESS" me rrjetin e transmetimit nuk ka përfunduar, pasi shoqëria ka deklaruar se do të vijojë me aplikimin pranë OST sh.a., pas regjistrimit të impiantit nga ERE. Si e tillë shoqëria duhet të pajiset me miratimin/marrëveshjen për pikën e lidhjes.
- Shoqëria ka detyrimin që gjatë operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS) të respektojë kufirin e fuqisë aktive totale të injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin, si dhe kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit dhe çdo detyrim tjetër që buron nga legjislacioni në fuqi.
- Shoqëria i nënshtrohet regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, për një periudhë jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike pas përfundimit të këtij afati, shoqëria duhet të ndjekë procedurën përkatëse të licencimit ose të modifikimit të licencës ekzistuese, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
- Për këtë vendimmarrje vlerësohet që të njoftohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të regjistrojë, impiantin e depozitimit të energjisë elektrike "Zëmblak BESS", të deklaruar nga shoqëria "ALBPOWER" sh.p.k., me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 60 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 240 MWh, në kuadër të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, njihet dhe lejohet të vijojë operimin, për periudhën kalimtare të përcaktuar në nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".
3. Për operimin e impiantit të depozitimit pas datës 14.07.2027, shoqëria duhet të aplikojë për licencën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
4. Çdo ndryshim në të dhënat e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike duhet të njoftohet nga shoqëria në ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të marrë masat për regjistrimin dhe pasqyrimin e të dhënave të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në Regjistrin përkatës të ERE-s, dhe në Fletën individuale të regjistrimit, në përputhje me

rregullat në fuqi, përfshirë cdo ndryshim të këtyre të dhënave të njoftuar nga shoqëria sipas pikës 4 të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "ALBPOWER" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**